



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Shqyrtimi i Tretë Tarifor i Energjisë Elektrike 2009 - Raporti Konsultativ

3 mars 2009

DEKLARATË

Ky raport konsultativ është përgatitur nga ZRrE për të pranuar komente nga palët e interesuara dhe nuk duhet të konsiderohet si dokument që paraqet vendim të ZRrE-së.

Përmbajtja

1	Hyrje	2
2	Qasja e shqyrtimit	2
3	Rregullimi për ndryshimin në mes të shpenzimeve të realizuara dhe atyre të lejuara	3
4	Rregullimet pas shqyrtimit	4
4.1	Kostot e propozuara të importit dhe të eksportit.....	4
4.2	Jetëgjatësia e Supozuar e Aseteve	6
4.3	Humbjet e Lejuara	7
4.4	Shpenzimet e Lejuara të mirëmbajtjes për KOSTT	7
4.5	Shpenzimet e personelit të KOSTT	8
4.6	Shpenzimet për Materiale dhe Shërbime të Administratës Qendrore.....	8
4.7	Borxhet e këqija dhe kapitali punues.....	9
5	Përmbledhje e të ardhurave të lejuara	9
6	Rregullimet e Propozuara Tarifore	10

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji është në procesin e shqyrtimit të tretë tarifor të tarifave të energjisë elektrike që do të aplikohen nga KEK sh.a. dhe të tarifave të transmisionit që do të aplikohen nga KOSTT sh.a. nga data 1 prill 2009. Ky shqyrtim përfshin nivelin e të ardhurave të lejuara që duhet të mbliidhen nga KEK dhe KOSTT ("të licencuarit") në 2009-2010 nga tarifatat dhe ngarkesat e rregulluara, si dhe strukturat e këtyre tarifave dhe ngarkesave.

ZRrE ka pranuar aplikacionin final për tarifa nga KEK-u dhe KOSTT-I më 18 shkurt 2009. Ky dokument paraqet qëndrimet e ZRrE-së për këto aplikacione dhe propozimet për tarifa të reja që duhet të hyjnë në fuqi më 1 prill 2009. Komentet eventuale nga palët e interesuara, për këto propozime dhe për aplikacionet në përgjithësi, janë të mirëseardhura. Komentet do të pranohen deri më 13 mars 2009, dhe do të merren në konsideratë gjatë marrjes së vendimit përfundimtar të ZRrE-së.

Komentet eventuale duhet të dërgohen përmes postës elektronike në adresën ero.pricing-tariffs@ero-ks.org, me titull "Komente për SHTE₃", apo të dërgohen në adresën e paraqitur në faqe të parë, të adresuar për "Departamentin për Tarifa dhe Çmime".

Në këtë fazë, ZRrE nuk ka marrë vendim mbi tarifatat të cilat do të aprovohen. Propozimet në këtë dokument duhet të konsiderohen si preliminare, dhe ofrohen si bazë për t'u komentuar.

2 Qasja e shqyrtimit

Qasja e ZRrE-së për shqyrtimin e aplikacioneve ka qenë si vijon:

- ZRrE fillimisht ka verifikuar nëse kalkulimet e kostove të lejuara dhe të hyrave në secilin aplikacion janë në pajtueshmëri me metodologjinë tarifore dhe modelin tarifor të aprovuar nga ZRrE. Ato kategori të shpenzimeve të cilat nuk kanë qenë në pajtueshmëri me metodologjinë tarifore apo modelin tarifor janë korrigjuar. Ndryshime të konsiderueshme janë bërë në llogaritjen e zhvlerësimit dhe të kthimit të lejuar për KEK.
- Në pajtim me metodologjinë tarifore të ZRrE-së, janë bërë rregullime edhe për ndryshimet në mes të shpenzimeve kapitale të lejuara dhe atyre të realizuara në vitin 2008, për ndryshimet në mes të vëllimit të humbjeve të lejuara dhe të realizuara për KOSTT, si dhe kompensimi për vonesën e hyrjes në fuqi të tarifave të vitit 2008, që rezultuan në aplikimin e tarifave të vitit paraprak për muajt prill dhe maj.
- Pas këtyre rregullimeve, ZRrE ka shqyrtuar me kujdes secilin element të aplikacionit të dorëzuar. Shqyrtimi ka marrë në konsideratë arsyeshmërinë e kërkesave për të ardhura të lejuara të paraqitura në aplikacion. Pas këtij shqyrtimi, ZRrE ka bërë rregullime në kategoritë në vijim:

Rregullimi për ndryshimin në mes të shpenzimeve të realizuara dhe atyre të lejuara

- Kostot e supozuara të importit dhe të eksportit
- Jetëgjatësia e supozuar e asetëve
- Humbjet e lejuara të transmisionit dhe të distribucionit për KOSTT dhe KEK, përkatësisht.
- Shpenzimet e lejuara të mirëmbajtjes për KOSTT
- Shpenzimet e lejuara të personelit për KEK dhe KOSTT
- Shpenzimet e lejuara për materiale dhe shërbime të Administratës Qendrore të KEK
- Përfshirjen e borxheve të këqija dhe kapitalit punues për KEK

Rregullimet e lartpërmendura janë përmbledhur në vijim.

3 Rregullimi për ndryshimin në mes të shpenzimeve të realizuara dhe atyre të lejuara

Sipas metodologjisë tarifore të ZRrE-së, nga të licencuarit kërkohet që të realizojë të gjitha investimet të cilat iu janë lejuar me tarifat e rregulluara, duke marrë parasysh rëndësinë e këtyre investimeve për Kosovën. Në rast se investimet e lejuara nuk janë realizuar, ZRrE rregullon të ardhurat e lejuara në shqyrtimin që pason, duke zbritur shpenzimet e zhvlerësimit dhe kthimin e lejuar, që shkaktohen nga investimet që janë lejuar por nuk janë realizuar. Ky rregullim është aplikuar për KEK dhe KOSTT. Efekti i këtij rregullimi është reduktimi i të ardhurave të lejuara me përafërsisht €7.9 milion për KEK dhe për një sasi të vogël për KOSTT.

ZRrE poashtu ka bërë një rregullim prej 0.1 milion euro si kompensim ndaj KOSTT për humbjet shtesë të transmisionit që KOSTT është detyruar t'i blejë në vitin 2008 krahasuar me nivelet e lejuara, që është rezultat i vëllimit më të madh të energjisë që është bartur në rrjetin e transmisionit krahasuar me vëllimin që është pritur.

Siç është vendosur në vendimin e vitit të kaluar, ZRrE ka rritur të ardhurat e lejuara për KEK dhe KOSTT për të kompensuar për ndryshimin në mes të të hyrave të lejuara dhe aktuale në muajt prill dhe maj të vitit 2008, e që kanë rezultuar nga vonesa e hyrjes në fuqi të tarifave të reja. Kjo ka kontribuar me një shtim prej 0.5 milion euro të të ardhurave të lejuara të KEK dhe 0.25 milion euro të të ardhurave të lejuara të KOSTT për vitin 2009.

Efekti i këtyre rregullimeve dhe përmirësimet në llogaritjet e të ardhurave të lejuara në aplikacionin tarifor ka bërë që të ardhurat e lejuara të zvogëlohen për rreth 5 milion euro.

4 Rregullimet pas shqyrtimit

Përderisa ZRrE ka shqyrtuar të gjitha elementet e aplikacionit tarifor, diskutimi në vijim është fokusuar vetëm në ato elemente të cilat përmbajnë ndryshime të ndjeshme. Edhe pse ZRrE nuk ka propozuar ndryshime në shpenzime kapitale të propozuara në aplikacion, ZRrE ua tërheq vërejtjen të licencuarve për nevojën e realizimit të këtyre investimeve në mënyrë që të evitohen zbritje të mëdha kompenzuese për vitin 2010. ZRrE do të monitorojë aftësinë e KEK dhe KOSTT për të realizuar investimet, duke marrë parasysh faktin se në vitin 2008 këto investime nuk janë realizuar.

ZRrE nuk propozon ndryshime në kërkesën e kostos së lejuar të kapitalit, duke e mbajtur këtë në 13.8%, pas marrjes parasysh të pasigurisë së ndikimit të krizës globale financiare dhe ndikimin e saj në kostot e financimit në Kosovë. Kamatat në Bankën Qendrore të Evropës janë zbritur dhe pritet që të zbriten edhe më tej, gjë që do të zvogëlojë koston e financimit. Megjithatë, këto zbritje mund të eliminohen me rritjen e kostos së financimit për tregjet në rritje.

4.1 Kostot e propozuara të importit dhe të eksportit


Në aplikacionin final, KEK ka supozuar se do të importojë 521.5 GWh energji elektrike, me çmim mesatar prej 125€/MWh. KEK poashtu ka supozuar se do të eksportojë 182.5 GWh energji elektrike me çmim mesatar prej 45€/MWh.

Në vitin 2008 si dhe në vitet më parë, KEK ka mbuluar një pjesë të nevojave për import përmes shkëmbimeve afatshkurtra që janë kontraktuar pa parashikim, për shkak të ndryshimeve të kushteve në sistemin energjetik. Pritet që KEK të vazhdojë shkëmbimin në këtë mënyrë, edhe pse vëllimi i këtyre shkëmbimeve nuk dihet kur merret parasysh natyra *ad hoc* e tyre. Kostoja e këtyre shkëmbimeve është kostoja e prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë, duke përfshirë edhe "koeficientin" (raportin në mes të eksporteve dhe të importeve në shkëmbimin e energjisë). Kjo kosto do të jetë shumë më e ulët krahasuar me çmimin e importeve të kontraktuara¹.

Për krahasim, kostoja mesatare e importit, siç është raportuar nga KEK në vitin 2008, ka qenë 112.5€/MWh, duke u ngritur në fund të vitit, siç mund të shihet në Figurën 1. Çmimi mesatar i eksportit ka qenë 36.6 €/MWh.

¹ Është e pamundshme të zëvendësohet importi i kontraktuar me energjinë e shkëmbyer, meqenëse shkëmbimi i energjisë nuk është stabil, dhe nuk është e gatshme kur kërkohet. Ato kryesisht jepen si pjesë e bashkëpunimit të sistemeve fqinje në mënyrë që të menaxhohen probleme afatshkurtra dhe nuk ofrojnë import të vazhdueshëm për t'i shërbyer kërkesës bazë.

Figura 1: Importet dhe Eksportet në vitin 2008



Shënime:

Eksportet pasqyrohen si importe negative.

Figura nuk përfshin shkëmbimet e energjisë

Në kuartalin e fundit të vitit 2008, KEK ka raportuar se kostoja mesatare e importit ka qenë 123€/MWh. Në atë kohë, kostoja mesatare e energjisë bazë në Qendrën Evropiane për Shkëmbin të Energjisë (European Energy Exchange –EEX), pika kryesore krahasuese për BE, ka qenë 68€/MWh². Në mes të Janarit 2009, mesatarja e çmimit spot të energjisë bazë në EEX ka qenë 65.5 €/MWh. Nëse supozohet se i vlen raporti njëjtë , atëherë kjo implikon që çmimet e importit duhet të jenë rreth 120€/MWh, edhe pse kjo mesatare pritet të zvogëlohet përderisa qartësohen vështirësitë e furnizimit të gazit në mes të Rusisë dhe Ukrainës, ngrohjes së motit si dhe ndikimit të vështirësive ekonomike në kërkesën për energji. Për vitin 2010, çmimet më të vonshme të kontraktuara janë mesatarisht 53.4 €/MWh për energji bazë (ose rreth 108 €/MWh, nëse raportet në mes të çmimeve të importit në Kosovë dhe EEX nuk ndryshojnë).

² Mesatarja e çmimeve bazë Phelix. Të dhënat janë të gatshme në www.eex.com.

Duke marrë parasysh këto, dëshmitë në çmimet e EEX sugjerojnë se çmimi mesatar prej 125 €/MWh i parashikuar nga KEK duket të jetë i mbivlerësuar, prandaj ZRrE propozon që çmimi i importit të zbritet në 112.4 €/MWh, që është i njëjtë me çmimin e realizuar të importit për vitin 2008. Kjo sjell një zbritje të të ardhurave të lejuara prej 6.5 milion euro .

4.2 Jetëgjatësia e Supozuar e Aseteve

Në aplikacionin tarifor, KEK ka propozuar zbritje të jetëgjatësisë së asetëve që përdoret për kalkulimin e zhvlerësimit si vijon:

- Minierat – zbritje e jetëgjatësisë nga 35 vjet në 16 vjet (duke barazuar jetëgjatësinë me jetëgjatësinë e propozuar të gjenerimit)
- Gjenerimi – zbritje nga 30 vjet në 16 vjet.
- Rrjeti (Distribucioni) – zbritje nga 40 vjet në 30 vjet.
- Furnizimi – pa ndryshime nga e tanishmja (5 vjet).
- Administrata Qendrore – zbritje nga 8 vjet në 5 vjet.

Zbritja e jetëgjatësisë së asetëve rezulton me rritje të vlerës së tanishme të ngarkesës për zhvlerësim, mirëpo po ashtu rezulton me zbritje të vlerës së tanishme të kthimit (meqenëse asetet zhvlerësohen më herët). Vlera e tanishme e shumës së ngarkesës së zhvlerësimit dhe të kthimit nuk duhet të ndryshojë, prandaj zbritja e jetëgjatësisë do të rezultojë në rritje të të ardhurave të lejuara dhe të tarifave në vitet e para, që do të kompensohet duke zbritur tarifat në vitet e mëvonshme.

ZRrE vëren se propozimi i KEK është bazuar në parashikimin e jetëgjatësisë ekonomike të secilit grup të asetëve. ZRrE pajtohet se është parimisht korrekt që për qëllime zhvlerësimi të merret parasysh jetëgjatësia ekonomike e asetëve, dhe jo ajo teknike. Megjithatë, ZRrE nuk pranon të gjitha ndryshimet e propozuara nga KEK.

Ndryshimet e propozuara nga ZRrE mbi jetëgjatësinë e asetëve janë si vijon:

- Minierat – pa ndryshim. ZRrE konsideron se asetet e minierave do të vazhdojnë të shërbejnë për centralin Kosova e Re edhe pasi që të mbyllen Kosova A dhe B.
- Gjenerimi – zbritje në 16 vjet, duke barazuar me datën e daljes nga funksioni të Kosovës A dhe B. Kjo varet nga konfirmimi i datës së paraparë të daljes nga funksioni të Kosovës A dhe B, për të cilat KEK ka deklaruar se do të dalin nga funksioni më 2027 (pas 18 vjetësh).
- Rrjeti – zbritje në 35 vjet, duke e barazuar me jetëgjatësinë e supozuar të asetëve të transmisionit, për arsye të konsistencës.
- Furnizimi – pa ndryshim.

- Qendra Administrative – zbritje nga 8 vjet në 5 vjet për arsye të konsistencës me jetëgjatësinë e propozuar të aseteve të Furnizimit.

Kjo rezulton në zbritje prej 2 milion euro të të ardhurave të lejuara për KEK dhe KOSTT.

4.3 Humbjet e Lejuara

Si KEK-u ashtu edhe KOSTT-i kanë kërkuar rritje të humbjeve të lejuara që duhet të mbulohen nga tarifat e rregulluara. KEK ka kërkuar që niveli i humbjeve komerciale³ të rritet në 22.7% krahasuar me nivelin e lejuar prej 20% në vitin 2008 dhe atë të realizuar prej prej 25.8% në vitin 2008. Humbjet teknike të kërkuara për vitin 2009 janë 17.1%, që janë në të njëjtin nivel me humbjet e realizuara për vitin 2008, dhe më të ulëta krahasuar me nivelin e lejuar prej 17.4% në vitin 2008. KOSTT poashtu ka kërkuar humbje të lejuara të transmisionit prej 4.6%⁴, që është në nivel të njëjtë me vlerat aktuale të vitit 2008, krahasuar me nivelin e lejuar prej 3.9% në vitin 2008. dhe

ZRrE thekson se humbjet në rrjetin e transmisionit dhe distributionit nuk duhet të pësojnë rritje. Qëllimi i programeve të vazhdueshme të investimeve, kostot e të cilave lejohen në të ardhura të lejuara, është të zvogëlohen humbjet. Përderisa mund të kemi vonesa në realizimin e këtyre investimeve, kjo është përgjegjësi e të licencuarve dhe ndikimi i këtyre vonesave nuk do të mbulohet nga konsumatorët.

Duke pasur parasysh këtë, ZRrE propozon që niveli i caktuar i humbjeve për vitin 2009 të jetë i njëjtë me atë të vitit 2008 (37.4% për KEK dhe 3.9% për KOSTT). Kjo paraqet zbritje të humbjeve të kërkuara nga KEK dhe KOSTT.

4.4 Shpenzimet e Lejuara të mirëmbajtjes për KOSTT

Në vitin 2008, të ardhurat e lejuara për KOSTT kanë përfshirë provizione për shpenzime të mirëmbajtjes prej 6.5 milion euro. Ndërkaq, KOSTT ka shpenzuar vetëm 2.7 milion euro. Për vitin 2009, KOSTT kërkon t'i lejohen 5.1 milion euro.

³ Humbjet jo-teknike janë ato humbje që nuk mund t'i atribuohen rezistencës së linjave dhe transformatorëve që përdoren për transportin e energjisë elektrike (këto humbje teknike ndodhin në të gjitha sistemet energjetike, edhe pse niveli i tyre rritet në rrjete të cilat nuk kanë mirëmbajtje të rregullt dhe rrjete ku energjia e transportuar është përafërsisht e njëjtë me kapacitetin e rrjetit). Humbjet jo teknike janë humbjet që rezultojnë nga vjedhjet, problemet në lexim të njehsorëve dhe gabimet në faturim.

⁴ Për të qenë konsistent me Rregullat e Tregut, humbjet e lejuara të KOSTT janë shprehur me Faktorin e Humbjeve të Transmisionit (TLF) dhe jo me përqindje të humbjeve të lejuara. Përqindja e humbjeve të lejuara përdoret në këtë dokument ngase është më e lehtë për t'u kuptuar. Përqindja e humbjeve mund të konvertohet në TLF duke përdorur formulën $1 / (1 - \text{humbet në } \%)$.

ZRrE, duke pasur parasysh brengën se KOSTT mund të dështojë të shpenzojë të ardhurat e lejuara për kategori, propozon të zvogëlojë të ardhurat e lejuara për mirëmbajtje në 3.9 milion euro, apo përafërsisht mesatarja në mes të shpenzimeve të kërkuara në vitin 2009 dhe atyre të realizuara në vitin 2008, që paraqet një zbritje në të ardhura të lejuara për 1.2 milion euro. Kjo megjithatë paraqet ngritje të konsiderueshme në krahasim me shpenzimet e realizuara në vitin 2008. ZRrE do të monitorojë për së afërmi shpenzimet e realizuara të KOSTT-it të kësaj shume të lejuar.

4.5 Shpenzimet e personelit të KOSTT

Aplikacioni i dorëzuar nga KEK paraqet rritje në numrin total të stafit në 7,899, që është pwr 365 më shumë sesa numri i lejuar në vitin 2008 dhe 390 më shumë sesa numri i punësuar aktualisht. Është vështirë të kuptohet arsyeshmëria e një ngritjeje kaq të madhe të numrit të personelit.

Duke marrë parasysh këtë, ZRrE propozon të mbajë numrin e lejuar të personelit në atë që është aprovuar në vitin 2008⁵. ZRrE poashtu do të studiojë edhe më tej arsyeshmërinë e nivelit të stafit, posaçërisht duke i krahasuar ato me nivelet e stafit në kompanitë në regjion.

ZRrE poashtu vëren se aplikacioni final i KOSTT propozon ngritje të konsiderueshme (rreth 11%) të shpenzimeve të lejuara të personelit në vitin 2008. Kjo duket e mbivlerësuar. Kjo ngritje tejkalon rritjen mesatare në shpenzimeve të personelit të KEK-ut, edhe pse rroga mesatare në KOSTT është dukshëm më e madhe krahasuar me rrogën mesatare në KEK. Aplikacioni i KOSTT po ashtu kërkon rritje të numrit të personelit për vitin 2008, që janë paraqitur me parashikimin e KOSTT për punësimin afatgjatë.

Duke pasur parasysh këtë, ZRrE propozon të ndalojë rritjen në shpenzimet mesatare të personelit të KOSTT në të njëjtin nivel me KEK, dhe të mbajë numrin e personelit në atë të vitit 2008.

Kjo rezulton në reduktim prej 2.5 milion euro të të ardhurave të lejuara.

4.6 Shpenzimet për Materiale dhe Shërbime të Administratës Qendrore

Në aplikacionin përfundimtar, KEK ka kërkuar 3.2 milion euro për shpenzime për materiale dhe shërbime në divizionin e administratës qendrore. Për krahasim, shpenzimet e lejuara për vitin 2008 në këtë kategori kanë qenë 0.6 milion euro, dhe janë realizuar rreth 1 milion euro.

Një rritje kaq e madhe e shpenzimeve të kërkuara duket e paarsyeshme. Siç është bërë me kostot e kërkuara të mirëmbajtjes të KOSTT, ZRrE do të lejojë një shumë që është përafërsisht e barabartë

⁵ Në disa raste, kjo lejon numrin e lejuar të stafit të disa bizneseve individuale të tejkalojnë ato të propozuara nga KEK. Në këto raste, megjithatë, kompensohen me rastet kur numri i lejuar i stafit është nën nivelin e propozuar.

Përmbledhje e të ardhurave të lejuara

me mesataren e shpenzimeve të realizuara të vitit 2008 dhe ato të kërkuara të vitit 2009. Kjo paraqet reduktim prej 1.1 milion euro nga të ardhurat e lejuara.

4.7 Borxhet e këqija dhe kapitali punues

Aplikacioni i dorëzuar nga KEK përmban kërkesën për lejimin e 3.2 milion euro për borxhe të këqija dhe 0.7 milion euro për kosto të financimit të kapitalit punues përmes të kredive afatshkurtra. Në pajtueshmëri me metodologjinë tarifore dhe vendimet e mëparshme, ZRrE propozon të mos lejojë asnjërën nga këto kosto. Është vendosur më parë që kostot e humbjeve në faturim, duke përfshirë edhe borxhet e këqija, nuk duhet të mbulohen nga konsumatorët që paguajnë faturat e tyre. Sa i përket koston së kapitalit punues, ZRrE tashmë lejon marzhën e furnizimit që përfshinë mbulimin e këtyre kostove.

Kjo rezulton në reduktim prej 3.9 milion euro të të ardhurave të lejuara.

5 Përmbledhje e të ardhurave të lejuara

Krahasimi i të ardhurave të lejuara në vijim paraqet:

- Të ardhurat e lejuara të aprovuara nga ZRrE në vitin 2008
- Të ardhurat e lejuara të kërkuara në vitin 2009 siç janë paraqitur në aplikacionin tarifor të dorëzuar nga KEK dhe KOSTT
- Të ardhurat e lejuara për vitin 2009 pas korrigjimeve dhe rregullimeve për mbishpenzime dhe nën-shpenzime në vitin 2008, të aplikuara nga ZRrE
- Të ardhurat e lejuara të propozuara nga ZRrE për vitin 2009, pas aplikimit të rregullimeve shtesë të janë përshkruara më lartë.

Pas këtyre rregullimeve, ZRrE propozon rritje të të ardhurave të lejuara prej 2.5% për vitin 2009, krahasuar me nivelin e kërkuar prej 18.3% të kërkuara nga KEK dhe KOSTT.

Ky propozim përfshinë subvencionin prej 42 milion euro që do të ofrohet nga Qeveria e Kosovës për KEK. Ky subvencion ka ndikim thelbësor në zvogëlimin e të ardhurave që duhet të mbulohen nga tarifatat e rregulluara. Nëse ky subvencion nuk do të ofrohej, atëherë të ardhurat e lejuara do të duhej të rriteshin për më tepër se 30%, edhe pas zbritjeve të bëra nga ZRrE.

Tabela 1: Përshkrim i të ardhurave të lejuara

Te ardhurat nga Tarifat e Rregulluara		2008	2009	2009	2009
		Lejuar	Kerkuar	Korrigjuar	Propozuar
KEK (Nuk përfshihen ndër-pagesat / Përfshihen kostot e AQ)					
Minierat	€000	46,324	59,397	53,506	50,309
Gjenerimi	€000	37,692	41,953	43,404	42,226
Rrjeti	€000	24,298	24,823	24,832	23,446
Furnizimi	€000	16,866	22,062	21,776	12,108
Gjithsejtë	€000	125,180	148,235	143,517	128,089
KOSTT (nuk përfshihen ndër-pagesat)	€000	11,290	13,251	13,223	11,828
Gjithsejtë	€000	136,469	161,486	156,740	139,917
Ndryshimi nga të ardhurat e lejuara 2008			18.3%	14.9%	2.5%

6 Rregullimet e Propozuara Tarifore

Aplikacioni i pranuar nuk propozon ndryshime në strukturën e tanishme tarifore, edhe pse KEK ka propozuar një mënyrë të kalkulimit të tarifës që reflekton kostot për grupet e konsumatorëve, që ndryshon nga mënyra kalkulimit e ZRrE-së. ZRrE planifikon të shqyrtojë këtë metodologji tarifore në mënyrë të detajuar para shqyrtimit të ardhshëm tarifor.

KEK ka propozuar që tarifat për grupet e konsumatorëve jo shtëpiakë të rritet me të njëjtën përqindje, por që tarifat për konsumatorë shtëpiakë të rriten me një përqindje më të madhe ngase këto tarifa janë më larg tarifave që reflektojnë kostot (siç janë kalkuluar nga KEK). KEK poashtu propozon që konsumatorët shtëpiakë nuk mund të mbesin në kategorinë e konsumatorëve pa njehsorë (kategorinë 7) për më shumë se 90 ditë.

ZRrE propozon që është korrekte të ngritën të gjitha tarifat me të njëjtën vlerë, përderisa është duke studiuar metodologjinë e propozuar të vlerësimit të tarifave që reflekton kostot të dorëzuar nga KEK. ZRrE do të vazhdojë të shqyrtojë metodologjitë e ndryshme të alokimit të kostos dhe mund të bëj ndryshime në këtë propozim para se të marrë vendimin për tarifat përfundimtare.

Në vlerësimin e përcaktimit të tarifës që kërkohet për të arritur të ardhurat e lejuara, është e nevojshme të vlerësohet ndryshimi i vëllimit të shitjeve të energjisë. ZRrE konsideron se është një nivel i lartë i pasigurisë mbi vëllimin e shitjeve në këtë vit, kur merret parasysh kriza ekonomike, nuk pritet të ketë rritje të madhet ë vëllimit të energjisë së shitur. Bilancet energjetike të pranuar janë parashikime nga KEK dhe KOSTT, për të cilat ZRrE konsideron se vëllimi i shitjes nuk paraqet situatë të pritshme reale.

Duke u bazuar në shqyrtimin e tërësishëm të aplikacionit, pas rregullimeve dhe korrigjimeve të bëra, ZRrE propozon që rritja e tarifave të jetë e njëjtë me rritjen e të ardhurave të lejuara të propozuar nga ZRrE (apo në mesatare 2.5% për të gjitha tarifat). ZRrE do të vazhdojë të vlerësojë bilancin e propozuar energjetik, i cili përfshinë ndryshimet e reduktimit të prodhimit të Ferronikelit, dhe mund të bëjë rregullime të këtij shqyrtimi para se të merret vendimi përfundimtar për tarifat e vitit 2009. Gjatë vitit 2010, ZRrE do të shqyrtojë dhe rregullojë të ardhurat e lejuara për mbi-mbulim apo nën-mbulim të të ardhurave të lejuara që mund të rezultojnë nga ndryshimet në mes të vëllimeve të realizuara dhe atyre të lejuara të shitjes së energjisë elektrike⁶.

⁶ ZRrE vëren se do të jetë e rëndësishme që të vazhdojë të ofrojë mekanizma që inkurajojnë KEK të zvogëlojë humbjet dhe se çdo rregullim eventual nuk duhet të reduktojë këta mekanizma.